

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Avdi Dinaj, kryetar, Nesrin Lushta e Nebojša Boričić-anëtar, me bashkëpunëtoren profesionale Qefsere Berisha, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të dënuarit D. R. nga Peja, për shkak të veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve të rrezikshëm dhe të substancave psiko tropikë dhe analoge nga neni 273.par.1.të KPK, duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë e të dënuarit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë P.nr.43/2016 të datës 18.04.2016. dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.305/2016 të datës 22.07.2016., në seancën e mbajtur më 22.11.2016., mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e të dënuarit D. R. e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë P.nr.43/2016 të datës 18.04.2016. dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.305/2016 të datës 22.07.2016.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë P.nr.43/2016 të datës 18.04.2016. i dënuari D. R. është shpallur fajtor për veprën penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve të rrezikshëm dhe të substancave psiko tropikë dhe analoge nga neni 273.par.1.të KPK dhe është gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 9 (nëntë)

muajve dhe me dënim me gjobë në shumë prej 250 €. I është shqiptuar edhe dënimi plotësues i konfiskimit të narkotikut marihuanë në peshë prej 683 gr. I dënuari është obliguar të paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit.

Në procedurën ankimore, me aktgjykimin Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.305/2016 të datës 22.07.2016. është refuzuar si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të dënuarit dhe aktgjykimi i shkallës së parë është vërtetuar.

Kundër këtyre aktgjykimeve i dënuari ka paraqitur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që të anulohen dhe lënda të kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Prokurori i Shtetit me parashtresën KMLP.II.nr.193/16 të datës 20.10.2016. ka propozuar që kërkesa të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435. par. 1. lidhur me nenin 436. par. 1. të KPPK, vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe konstatojë se:

-kërkesa është e pabazuar.

Nga përmbajtja e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë rezulton se të gjitha pretendimet kanë të bëjnë me vendimin për dënimin. Kështu, pretendohet se në aktgjykimet e kundërshtuara nuk janë vlerësuar rrethanat lehtësuese siç janë se i dënuari gjykohet për herë të parë për veprë penale, rrethanat familjare-se është i vetmi mbajtës i familjes, se babai i tij vuan nga sëmurja e veshkave dhe ka nevojë për përkujdesje permanente, se sasia e narkotiku ka qenë e vogël dhe se i dënuari ma nuk e përdorë, ndërsa vlerësimi i këtyre rrethanave do të kishte ndikuar në marrjen e vendimit më të butë.

Gjykata Supreme konstaton se konform dispozitës së nenit 385. par. 5. të KPPK kur është fjala për vendimin për dënimin, shkelje e ligjit penal bëhet kur në marrjen e vendimit për dënim, dënim alternativ, vërejtje gjyqësore ose në marrjen e vendimit për masën e trajtimit të detyrueshëm për rehabilitim apo për konfiskim të dobisë pasurore të fituar me vepër penale, *gjykata ka tejkaluar kompetencat ligjore.*

Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë ka shqiptuar llojin e dënimit të paraparë për këtë vepër penale gjegjësisht dënim me burgim, e duke aplikuar institutin e zbutjes së dënimit, ka shqiptuar dënim nën minimumin e paraparë me ligj. Po ashtu ka shqiptuar dënimin me gjobë sepse për këtë vepër penale ligji ka paraparë edhe shqiptimin e dënimit me gjobë. Nga kjo rrjedhë se nuk mund të aprovohet pretendimi në kërkesë për shkeljen e ligjit penal.

Në rast se nuk është fjalë për këtë shkelje, vendimi për dënimin me këtë mjet të jashtëzakonshëm juridik mund të kundërshtohet vetëm nëse kjo pjesë e aktgjykimi është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e cila do të mund të ndërlihej me mungesën ose paqartësitë të arsyeve lidhur me vendimin për dënimin, mirëpo, në rastin konkret një pretendim i këtillë në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është paraqitur.

Nga këto arsye, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë ishte e pabazuar dhe konform nenit 437. të KPPK u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Pml.nr. 254/2016, më 22.11.2016.

Proçesmbajtësja,
Qefsere Berisha

Kryetari i kolegjit,
Avdi Dinaj